



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

Data 04.10.2010

Në bazë të nenit 11, nenit 12 pika 12.2 (c), nenin 34.4 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale Nr. 03/L- 040, Udhëzimin e MAPL-së 2008/8 Për Mërrëveshjet e bashkëpunimit të Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane si dhe Statutin e Komunës nenin 12,14 dhe 15 Kuvendi Komunës miraton:

**DRAFT RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS
ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE TË KOMUNËS SË
HANIT TË ELEZIT**

Neni 1
Qëllimi

Në bazë të kësaj draft rregulloreje, rregullohet organizimi dhe bashkëpunimi në mes të Komunës dhe Fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Hanit të Elezit, zgjedhja e këshillave, kompetencat dhe përgjegjësitë e këshillave duke ju siguruar qytetarët e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre në shumë fusha të jetës dhe paraqitje të organizuar para Komunës dhe organeve të saj, që realizohet në pajtim me statutin e Komunës, Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe akteve të tjera ligjore.

Neni 2

Konstituimi (themelimi) i këshillave të lokalitetit

- 2.1 Në Komunën e Hanit të Elezit, vetëqeverisja lokale ushtrohet në nivel të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
- 2.2 Territori për të cilën themelohen lagjet urbane, janë kufijtë e lagjeve urbane sipas planit urbanistik të qytetit. Këshillat e fshatrave mbulojnë territorin brenda kufijve të fshatrave, sipas zonës kadastrale dhe vendbanimeve.
- 2.3 Në pamundësi që në çdo fshat vendbanim apo lagje urbane të zgjidhen këshillat atëherë një këshill mundet të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime apo lagje urbane.

Neni 3
Përgjegjësitë e bartura nga komuna në Këshill

1. Me kërkesën e Këshillit dhe rekomandimin e Kryetarit të komunës apo ndonjë Komitetit të Komunës, Komuna me vendim mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar Këshillat e vendbanimeve (fshatit apo lagjes urbane).
2. Komunat ofrojnë burime të mjaftueshme për fshatrat dhe lagjet urbane, me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartur

Neni 4
Bashkëpunimi i fshatrave dhe lagjeve urbane

Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Hanit të Elezit me pëlqimin e tyre mund të organizohen dhe bashkëpunojnë në mes veti për ushtrimin e aktiviteteve të përbashkëta të bartura nga komuna. Vendimin për bashkimin e fshatrave dhe lagjeve urbane e miraton Kuvendi Komunalë në bazë të kërkesës së fshatit apo lagjes.

Neni 5
Organizimi i vendbanimeve (fshatrave, dhe lagjeve urbane)

1. Secili fshat, apo lagje urbane e komunës zgjedhë Këshillin dhe Kryetarin e fshatit apo lagjes, përmes votimit të fshehtë apo të hapur në tubimin e qytetarëve.
2. Në përbërjen e Këshillit të fshatit apo lagjes urbane duhet respektuar parimet e përfaqësimit gjinor, dhe të përfshihen së paku 30 % e femrave.
3. Këshilli i fshatit apo lagjes mund të ketë prej 5 deri në 17 anëtar. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill përcaktohet me vendim të Kuvendit të Komunës në bazë të kësaj rregulloreje.
4. Këshilli dhe Kryetari i fshatit dhe lagjes urbane zgjedhet me mandat 4 vjeçar.
5. Këshilli, anëtarët dhe Kryetari i këshillit aktivitetin e tyre e zhvillojnë sipas vendimeve të nxjerrura nga Kuvendi i Komunës dhe në pajtueshmëri me këtë rregullore.
6. Këshilli, anëtarët dhe Kryetari i këshillit mund të shkarkohen edhe para kalimit të mandatit, nëse nga zgjedhësit e tyre konstatohet se nuk kane kryer obligimet që dalin nga kjo rregullore dhe legjislacioni i zbatueshëm.

7. Shkarkimi i këshillit dhe Kryetarit të këshillit bëhet sipas procedurës së njejtë zgjedhjes së Këshillit dhe Kryetarit

Neni 6

Kompetencat dhe përgjegjësitë e këshillit

Këshilli i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara si më poshtë:

- Harton dhe miraton rregulloren e punës së këshillit në bashkpunim me komunën
- Organizon, përcjellë dhe planifikon zhvillimet e lokalitetit në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, Komitetet dhe drejtoritë komunale;
- Emëron komisionet përkatëse për t'i realizuar objektivat e fshatit, vendbanimit dhe lagjes;
- Harton planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat në bashkpunim me komunën
- Ndërmerr iniciativa për ruajtjen e objekteve në pronësi të komunës dhe në pronësi shtetërore dhe pasurive tjera të paluajtshme shtetërore në lokalitetin përkatës;
- Bën llogarinë 6 mujore dhe atë vjetore të mjeteve të inkasuara dhe i bënë ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti në harmoni me dispozitat e Statutit të Komunës dhe kësaj rregulloreje;
- Siguron të dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjellë gjendjen ekonomike të tyre dhe jep rekomandime e propozime në lidhje me këto;
- Cakton persona përgjegjës të cilët ngarkohet me faturat për përcjelljen e gjendjes financiare të lokalitetit sipas kategorive të cilat caktohen me vendim të posaçëm të Këshillit të lokalitetit;
- Këshilli nxjerr vendime dhe rekomandime në interes të qytetarëve të lokaliteteve në komunë, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm;
- Në bazë të nevojave dhe të kërkesës së qytetarëve apo me iniciativën e Këshillit mundë të përcaktohet grumbullimi i vetëkontributit të qytetarëve në pajtueshmëri me legjislacionin e zbatueshëm.

Neni 7
Bashkëpunimi i organeve të komunës me këshillat e lokaliteteve

Kryetari i Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale të Komunës së Hanit të Elezit, koordinojnë punët me këshillat e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane përmes Kryetarëve të Këshillave, varësisht nga specifikat që do të trajtohen.

Neni 8
Mosëpërbushja e përgjegjësi

1. Për të gjitha punët e bartuar në Këshill nga Kuvendi i Komunës, Këshilli i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane përkatëse mban obligime dhe përgjegjësi ligjore në rast të keqpërdorimit eventual.
2. Përgjegjësia mund të jetë individuale apo kolektive para qytetarëve dhe organeve përkatëse.

Neni 9
Epërsia e aktit

Në rast të konfliktit të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe Ligjit Për Vetëqeverisje Lokale apo Statutit të Komunës mbizotrojnë dispozitat e ligjit apo statutit.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale.

Kryesusi I Kuvendit
Menduh Vlashi
